




SOLID 2.0

Sistemi për Ngrohjen e Duhanit

Manual Përdorimi



1. Emri dhe përbërësit e secilës pjesë



Mbulesa e pjesës ku vendoset fija

Kapaku

Styler Deco

Butoni (Treguesi LED)

Duke shtypur Butonin ose kur pajisja vendoset në prizë nëpërmjet Portës së Karikimit, shfaqet gjendja e karikimit të pajisjes.

Blu
100~60%

Blu e Akullit
60~30%

Portokalli
30~1%

E kuqe
ka nevojë të
karikohet



Porta e Karikimit


- Karikojeni pajisjen përpara përdorimit të parë.
- Duhet afërsisht 2 orë që të karikohet plotësisht, e disponueshme për përdorim për afërsisht 25 fije (numri i fijeve mund të ndryshojë në varësi të mjedisit ku përdoret).



! Përdorni vetëm Kabllin USB dhe Përshtatësin e rrymës AC të dizenuar për IIL SOLID™ 2.0, i cili vjen me pajisjen tuaj.

! Mund ta karikoni pajisjen kurdo që t'ju vijë mbarë, pavarësisht gjendjes së karikimit të baterisë.

2. Përmbajtja e Kutisë



3. Paralajmërimet për Sigurinë dhe Udhëzimet

Lexoni me kujdes të gjitha instruksionet që jepen në këtë Manual Përdorimi përpara përdorimit për të vënë në punë pajisjen në mënyrë të sigurt dhe korrekte.

Paralajmërimet për Sigurinë dhe Udhëzimet e dhëna në këtë Manual Përdorimi nuk mund të mbulojnë të gjitha situatat e mundshme, të cilat mund të ndodhin gjatë përdorimit të pajisjes. Duhet të tregohet kujdes kur përdoret apo mirëmbahet një pajisje elektronike.


Ruajini këto paralajmërimet për sigurinë dhe udhëzime për referim të mëvonshëm pasi përmbajnë informacione të rëndësishme.

⚠ Dështimi për të ndjekur këto instruksione mund të rezultojë në lëndime personale.

Elektronika dhe bateria e pajisjes

- Mos e përdorni pajisjen me Kapakun e saj të hequr.
- Bëni kujdes të mos ju bjerë pajisja në ujë.
- Ky produkt nuk përmban pjesë rezervë për përdoruesin. Mos u përpiqni të hapni, modifikoni, çmontoni ose riparoni baterinë apo çdo pjesë përbërëse të kësaj pajisje.
- Nëse kjo pajisje duket të jetë e dëmtuar, e modifikuar, e çmontuar, që ka ndërhyrje, ose është zhytur në lëngje pas blerjes, mos e aktivizoni pajisjen.
- Mos e prekni pajisjen, përshtatësin e rrymës AC dhe Kabllin USB nëse mbinxehen, nxjerrin tym, ndizen, nxjerrin shkëndija ose digjen.
- Mos e përdorni pajisjen nëse ajo është ekspozuar ndaj nxehtësisë së tepërt.
- Mos e lidhni pajisjen me tela elektrike ose materiale metalike. Në rast se e bëni këtë mund të shkaktoni dëme.
- Mos e përdorni pajisjen nëse janë të pranishme materiale të djegshme, lëngje ose gazra ose në mjedise më sasi të larta të oksigjenit. Përdorimi në të tilla raste paraqet rrezik shpërthimi.
- Pajisja, përshtatësi i rrymës AC dhe Kablli USB nuk duhet

të ekspozohen ndaj lëngjeve, vajrave, tretësve, etj. Mos e prekni pajisjen ose pjesët e saj nëse lagen ose zhyten në lëngje, vajra, tretës, etj.

- Mos e pastroni pajisjen duke përdorur lëngje, vajra, tretës, etj.
- Duhet të tregohet kujdes që të mos futen materiale të tjera në pjesën e vendosjes së fijos. Mos e përdorni pajisjen pa pastruar më parë pjesët e tjera.
- Nëse ndonjë lëng që rrjedh nga pajisja bie në kontakt me lëkurën, lajeni pjesën e prekur, duke përfshirë duart, mos prekni sytë. Në rast se lëngu bie në kontakt me sytë, shpëlajini menjëherë me ujë të pastër, të rrjedhshëm për të paktën 15 minuta dhe kërkoni ndihmë mjekësore.
- Mos e përdorni pajisjen nëse ka rrjedhje nga bateria.
- Përdorni vetëm Kabllin USB dhe përshtatësin e rrymës AC që është dizenuar për lil SOLID 2.0. Shihni seksionin Të Dhënat Teknike të këtij Manuali për Përdorim për një listë të modeleve të miratuara të përshtatësve të rrymës. Mos përdorni kablllo dhe përshtatës rryme të tjerë – pasi kjo mund të shkaktojë dëmtime.
- Karikoni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura, siç tregohet në simbol .

Përdorimi dhe ruajtja

- Përdorni vetëm fije duhani me ngrohje Fiit™ të dizenuar posaçërisht për pajisjen lil SOLID. Funksionimi i pajisjes suaj nuk garantohet nëse e përdorni me materiale të tjera.
- Mos i përshtatni në asnjë mënyrë fijet e duhanit me ngrohje Fiit dhe mos shtoni substanca të tjera në fijet e duhanit me ngrohje Fiit. Përndryshe mund të shkaktoni lëndime.
- Mbajeni pajisjen, Kabllin USB, përshtatësin e rrymës AC dhe fijet e duhanit me ngrohje larg fëmijëve dhe kafshëve shtëpiake gjatë gjithë kohës. Kujdes: Pjesët mund të gëlltiten nga fëmijët.
- Kjo pajisje është për përdorim vetëm nga të rriturit. Fëmijët dhe minoret duk duhet ta përdorin këtë pajisje në asnjë lloj rrethane.
- Ndalohet shitja e pajisjes dhe fijeve të duhanit me ngrohje për minorenët.
- Mos e hiqni Kapakun ndërkohë që pajisja është në përdorim ose menjëherë pas përdorimit të pajisjes pasi pajisja mund të jetë e nxehtë. Lëreni pajisjen të ftohet përpara heqjes së Kapakut.
- Edhe kur fija e duhanit me ngrohje hiqet gjatë përdorimit,

procesi i ngrohjes vazhdon. Për ta ndërprerë, fikeni duke shtypur Butonin për 2 sekonda.

- Pastroni pajisjen pasi të ftohet.
- Pas heqjes së fijos së duhanit me ngrohje nga pajisja, mos e prekni pjesën e fijos së duhanit pasi mund të jetë e nxehtë pas përdorimit.
- Trajtojeni pajisjen me kujdes. Mos e rrëzoni pajisjen dhe mos e ekspozoni ndaj goditjeve të forta tronditëse.
- Ruajtja e pajisjes në vende me temperaturë të lartë (të tilla si brenda automjetit ose pranë burimeve të nxehtësisë, të tilla si radiatorët ose zjarri), lagështi të lartë ose në temperatura të ulëta mund të reduktojë punën e baterisë.
- Bateria e pajisjes mund të shterojë nëse lihet pa përdorur për një kohë të gjatë. Karikoni sërish baterinë përpara përdorimit.
- Fijet e duhanit me ngrohje të dizenuar posaçërisht për pajisjen lil SOLID janë për një përdorim. Mos e rivendosni në pajisje një fije duhani me ngrohje të përdorur. Funksimi i pajisjes nuk është i garantuar nëse rivendosen fijet e përdorura.
- Fijet e duhanit me ngrohje asnjëherë nuk duhet të ndizet me shkrepëse, çakmak ose ndonjë burim tjetër flake.

- Fijet e duhanit me ngrohje mund të shfaqin njolla ose çngjyrosje pas përdorimit normal.
- Mos e fusni pajisjen në gojë.
- Mos e përdorni pajisjen aty ku ndalohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
- Kjo pajisje nuk është menduar të përdoret nga persona me aftësi të kufizuara fizike ose mendore apo me mungesë të njohurive përveçse kur janë në mbikëqyrje ose ju jepen udhëzime për të përdorur produktin në mënyrë të sigurt dhe i kuptojnë rreziqet që përfshihen.
- Duke qenë e ekspozuar ndaj djersës, rrezeve UV dhe kimikateve në mënyrë të përsëritur mund të ndodhë çngjyrosje e pjesës së jashtme të pajisjes.
- Afrimeteti me fushën magnetike mund të shkaktojë keq-funksionim.

Duhani dhe nikotina

- Fijet e duhanit me ngrohje përmbajnë nikotinë, e cila krijon varësi. Nikotina është e pranishme në mënyrë natyrale në duhanin e përdorur në fijet e duhanit me ngrohje.
- Fijet e duhanit me ngrohje, në rast se gëlltiten, mund të paraqesin rrezik për intoksikim nga nikotina. Nëse gëlltiten

fijet e duhanit, kërkoni menjëherë kujdes mjekësor.

- Mënyra më e mirë për të reduktuar rreziqet shëndetësore që lidhen me duhanin është ndërprerja e përdorimit të duhanit dhe nikotinës së bashku.
- Ndërprerja e pirjes së cigareve apo kalimi tek produktet e tjera që përmbajnë nikotinë mund të kërkojë përshtatjen e dozimit të disa ilaçeve (p.sh. theophylline, clozapine, ropinirole).
- Përdorimi i fijeve të duhanit me ngrohje që përmbajnë nikotinë mund të shkaktojë efekte të tilla anësore si dhimbja e kokës, të përziera, acarim të fytit ose stomit. Nëse keni ndonjë nga këto simptoma, ndërprisni menjëherë përdorimin e produktit.
- Nëse jeni shtatzënë, mendoni se mund të jeni shtatzënë, ose jeni duke ushqyer me gji, apo keni sëmundje zemre, diabet, epilepsi, kriza apo gjendje të tjera serioze, duhet të ndërprisni përdorimin duhanit dhe nikotinës së bashku dhe të konsultohuni me një profesionit të kujdesit shëndetësor.
- Përdorimi i fijeve të duhanit me ngrohje mund të shkaktojë një reaksion alergjik.

Kërkoni menjëherë kujdes mjekësor nëse vini re ndonjë nga simptomat e mëposhtme: ënjtje të fytyrës, buzëve,

gjuhës, etj. dhe/ose vështirësi në frymëmarrje.

Raportimi i rasteve të dëmtimeve ose incidenteve


- Nëse keni ndonjë efekt të padëshiruar shëndetësor kur përdorni pajisjen, konsultohuni me një profesionit të kujdesit shëndetësor.
- Mund të raportoni rastet e dëmtimit apo incidentet direkt duke kontaktuar me Qendrën e Shërbimit ndaj Klientit në 0800 16 16.
- Duke raportuar efektet anësore, ju mund të ndihmoni të ofroni më shumë informacion në sigurinë e këtij produkti.

4. Përdorimi


1 Hapat përpara përdorimit



Pajisja është në gjendje të fjetur dhe nuk operon përveçse kur aktivizohet për përdorimin tuaj të parë. Për të aktivizuar pajisjen shtypni Butonin për 2 sekonda ose lidhni karikuesin me portën e karikimit.



Ndërkohë që pajisja aktivizohet, Treguesi LED pulson dy herë në të kuqe, portokalli, blu të akullt dhe blu, në mënyrë sekuencale.




Pasi pajisja aktivizohet, Treguesi LED pulson në blu të akullt or n sekondë dhe njëkohësisht ndodh vibrim dy herë.

Për të ruajtur jetëgjatësinë e baterisë, pajisja do të kthehet në gjendjen e fjetur:


- ① nëse nuk karikohet për 24 orë kur drita e Treguesit LED është e kuqe.
- ② nëse nuk përdoret për 7 ditë kur drita e Treguesit LED është portokalli, blu e akullt ose blu.



Merrni pajisjen tuaj.



Rrëshkiteni dhe hapeni. Mbulojeni pjesën e vendosjes së fijes në pjesën e sipërme të pajisjes.



Vendosni fijen e duhanit me ngrohje të dizenuar për lili SOLID në pjesën e vendosjes së fijes me pjesën e duhanit që sheh për poshtë dhe shtyjeni fijen derisa të prekë fundin e pjesës së vendosjes së fijes.


- Nëse vendosni fijen me pjesën e sipërme poshtë, pajisja mund të thyhet gjatë përdorimit. Lutemi kontrolloni drejtimin e vendosjes së fijes përpara përdorimit.
- Mbyllni kapakun e pjesës së vendosjes së fijes kur pajisja nuk është në përdorim për të parandaluar hyrjen brenda të substancave.




2 Ndezja e pajisjes



Shtypni Butonin për 2 sekonda deri sa të ndodhë vibrimi.




Pas 2 sekondave, Treguesi LED pulson në blu të akullt dhe njëkohësisht ndodh vibrim. Gjatë afërsisht 25 sekondash fillon procesi i para ngrohjes. Koha e zgjatjes së procesit të para ngrohjes mund të ndryshojë në varësi të ambientit.




Kur përfundon procesi i para ngrohjes, dritat e Treguesit LED ndizen dhe njëkohësisht ndodh vibrim. Kjo do të thotë që procesi i para ngrohjes ka përfunduar dhe fija është gati për përdorim.




3 Përdorimi



Pajisja me fijen e duhanit me ngrohje të dizenuar për lili SOLID është gat për t'u përdorur. Ju keni deri në 14 thithje ose 5 minuta, cilado vjen e para.



Për të sinjalizuar 30 sekondat e fundit të përdorimit ose 3 thithjet e fundit, cilado vjen e para, pajisja do të vibrojë një herë dhe Treguesi LED do të pulsojë në blu të akullt deri në fund të sesionit.



Kur përfundon sesioni, Treguesi LED dhe pajisja do të fikën automatikisht. Nuk është e nevojshme të shtypni Butonin.

Shtypni Butonin për 2 sekonda dhe hiqni fijen e duhanit vetëm nëse dëshironi të ndërprisni sesionin dhe përdorimin e pajisjes.





4 Heqja e fijos të duhanit me ngrohje



Rrotullojeni fijen në një drejtim 3 herë ose më shumë.



Tërhiqni fijen jashtë pajisjes.



Mbyllni Kapakun e pjesës së vendosjes së fijos.

Nëse fija nuk hiqet ashtu siç përshkruhet më sipër, mbetjet e fijos të përdorur mund të mbeten brenda.
Nëse ka disa mbetje brenda pjesës së vendosjes së fijos, referojuni **1** të **6. Zgjidhja e Problemeve**.


5 Përdorimet e vazhdueshme

Për përdorimin e vijueshëm, lutemi përsërisni hapat e mësipërm **1** – **4**. Mund të përdoret deri në 3 herë në vijim.




5. Pastrimi dhe trajtimi


1 Pastrimi me Pastruesin e Dyfishhtë




Merrni Pastruesin e Dyfishhtë.




Për të përdorur Fshirësin e Pastrimit, hapni anën me shenjë .



Për të përdorur Furçën Pastruese hapni me kujdes anën me shenjë .



Hiqni Kapakun nga pajisja.



Fusni Fshirësin e Pastrimit në pajisje dhe pastroni pajisjen duke rrotulluar përreth Fshirësin e Pastrimit.



Fusni Furçën e Pastrimit në pajisje dhe pastroni pajisjen duke rrotulluar përreth Furçën e Pastrimit.

* Ne rekomandojmë pastrimin e pajisjes pas përdorimit të 20 fijeve për një përdorim të përshtatshëm të pajisjes.

* Mos e pastroni pajisjen gjatë nxehtësie ose menjëherë pas përdorimit të pajisjes. Lëreni pajisjen të ftohet, përndryshe Fshirësi i Pastrimit ose Furça e pastrimit mund të shkrihen ose të ngjiten në pajisje.

* Tregoni kujdes që të mos lejon që Fshirësi i Pastrimit ose Furça e Pastrimit të bjerë në kontakt me ndonjë lëng, vaj, tretës, etj.

* Tregoni kujdes që të mos lejon që Fshirësi i Pastrimit ose Furça e Pastrimit të bjerë në kontakt me sytë.

* Mbani larg zjarrit Fshirësin e Pastrimit dhe Furçën e Pastrimit.

* Duhet treguar kujdes kur përdoret Fshirësja e Pastrimit dhe Furça e Pastrimit pasi mund të jenë të mprehta.


* Përdorimi i mjeteve të tjera për pastrim përveç Fshirësës së Pastrimit dhe Furçës së Pastrimit ose përdorimi i shtuar i forcës mund të dëmtojnë ngrohësin.




2 Pastrimi me nxehtësi



Shtypni shpejt Butonin 5 herë (brenda 2 sekondave).



Treguesi LED pulson në portokalli, për 90 sekonda dhe procesi i pastrimit vijon automatikisht.



Kur përfundon procesi i pastrimit, Treguesi LED automatikisht fiket dhe ndodh vibrimi 2 herë.

* Pastrimi me të nxehtë do të thotë nxehtë e mbetjeve të mbeten të ngecura në ngrohës. Ngrohësi mund të nxehet shumë, kështu që mos lejoni ndonjë gjë të bjerë në kontakt me ngrohësin gjatë ose menjëherë pas pastrimit me të ngrohtë.




6. Zgjidhja e problemeve

1 Nuk mund të vendos fijet në pajisje.

Nëse ka mbetje nga fija e mëparshme brenda pjesës së vendosjes së fijes, fija mund të mos futet në vend.

Pastroni mbetjet duke hequr Kapakun nga pajisja dhe përpiquni përsëri për të vendosur fijen.



Kontrolloni për ndonjë mbeturin brenda pjesës së vendosjes së fijes.




Nëse ka mbetje të ndonjë fije të përdorur, hiqni Kapakun nga pajisja.




Largoni mbeturinat nga Kapaku.


2 Pajisja ime nuk punon.



Drita e Treguesit LED është e kuqe për 3 sekonda dhe njëkohësisht ndodh vibrim 3 herë. Bateria është e pamjaftueshme. Karikoni pajisjen.



Treguesi LED pulson të kuqe 5 herë. Pajisja është duke funksionuar keq. Kthejeni pajisjen në gjendje fillestare.




Treguesi LED pulson në portokalli për 3 sekonda. Pas 3 sesioneve të njëpasnjëshme pajisja do të ftohet automatikisht. Lutemi prisni deri sa temperatura e pajisjes të stabilizohet.

* Për sigurinë tuaj, pajisja nuk mund të përdoret më shumë se 3 herë brenda 18 minutave pasi ka nevojë të ftohet. Duhet 3 minuta e 30 sekonda përpara se të përdoret sërish.


3 Si mund ta rikthej në gjendje fillestare pajisjen?



Shtypni Butonin për 8 sekonda, edhe nëse vibrimi ndodh brenda 2 sekondave.



Pajisja është kthyer në gjendjen fillestare dhe Treguesi LED pulson dy herë në të kuqe, portokalli, blu të akullt dhe blu në mënyrë sekuenciale.



Kur pajisja është kthyer plotësisht në gjendjen fillestar, Treguesi LED ndriçon në blu të akullt për 1 sekondë, dhe njëkohësisht ndodh 2 herë vibrim.

7. Asgjësimi

- Pajisja përdor bateri me jone litiumi. Asgjësojeni pajisjen tuaj në përputhje me rregulloret e zbatueshme.
- Lutemi kontaktoni autoritetet lokal të bashkisë për të mësuar më shumë informacion në lidhje me asgjësimin e pajisjes dhe përshtatësit të korrentit.

8. Të Dhënat Teknike

lil SOLID 2.0

Modeli: S-MONO-21


Lloji i baterisë: Jon Li – bateri e rikarikueshme

Hyrja: 5.0V \equiv 2.0A

Prodhuar në Malajzi

Prodhuesi: ELENTEC CO., LTD.

64-3, Dongtangiheung-ro, Hwaseong-si, Gyeonggi-do, Republika e Koresë

lil SOLID 2.0 është shënuar me simbolin [] pasuar nga "xx-1007EMTx," i cili vë në dukje se lil SOLID 2.0 mund të karikohet vetëm duke përdorur modelet e miratuara të Përshtatësit të Korrentit, të dizenuar për lil SOLID 2.0.

Përshtatës i rrymës AC

Modeli: HM-1007EMTE

Hyrja: 100-240V~ 50-60Hz 0.35A

Dalja: 9.0V \equiv 1.67A ose 5.0V \equiv 2.0A

Prodhuar në Vietnam

Prodhuesi: HAEM VINA Co., Ltd

Lot B4, Song Khe – Noi Hoang Industrial Zone, Song Khe Commune, Bac Giang City, Bac Giang Province, Vietnam

Kabëll USB

Prodhuar në Vietnam

Prodhuesi: CRESYN HANOI CO., LTD

Dong Tho Industrial Complex, Dong Tho Commune, Yen Phong District, Bac Ninh Province, Viet Nam

I përshtatshëm për portë karikimi tip C

Pastrues i Dyfishtë

Prodhuar në Malajzi

Prodhuesi: ELENTEC CO., LTD.

64-3, Dongtangiheung-ro, Hwaseong-si, Gyeonggi-do, Republika e Koresë



Për të gjetur muajin dhe vitin e prodhimit të pajisjes lil SOLID duhet të telefononi Qendrën e Shërbimit të Klientit dhe tregojini kodin 14 shifror alfanumerik të vendosur poshtë kapakut të pajisjes.

Viti i prodhimit të përshtatësit të rrymës AC tregohet në shifrën e parë të numrit serial të përshtatësit të rrymës AC (SN:YWWDXXXXX), ku Y=vitin; 1=2011, 2=2012, etj.

Kushtet e ruajtjes: në mjedise të thata të kondicionuar, regjimi i temperaturës: nga 5 °C deri në 30 °C lagështira mesatare më pak se 70%.

Lista e artikujve të përfshira në pajisjen lil SOLID për ngrohje elektrike të duhanit tregohen në paketim.

Afati kohor i shërbimit të artikujve të pajisjes lil SOLID për ngrohje elektrike të e duhanit është 12 muaj nga data e blerjes.

Qendra e Shërbimit të Klientit: 0800 16 16

Kujdes

Përdoreni këtë pajisje vetëm me fijet e duhanit me ngrohje të dizenuar për lil SOLID. Të përdoret vetëm nga të rritur. Fijet e duhanit me ngrohje shiten veçmas.

lil, lil SOLID dhe Fiit janë marka tregtare në pronësi të Korporatës KT&G dhe përdoret sipas licencës nga Philip Morris Products S.A.

IQOS është një markë tregtare në pronësi të Philip Morris Products S.A.